

1 E hënë, 2 mars 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjesi të gjithëve.

6 Ju lutem, ekipet të bëjnë prezantimet përkatëse, fillojmë
7 me Prokurorinë.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Z. Sullivan,
9 Pedersen, O'Connell, Josh Hafetz dhe unë Matt Halling të
10 pranishëm nga ana e Prokurorisë, të pranishëm në sallën e
11 gjyqit.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ekipet e Mbrojtjes.

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Jam këtu me
14 Cornelissen, Megan Hirst, Lirim Greicevci, edhe unë Sophie
15 Menegon.

16 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Rees.

17 Z. REES: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Ne jemi i njëjti ekip
18 si javën e kaluar, vetëm z. Newson nuk është i pranishëm.

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Edwards.

20 Z. EDWARDS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Njësoj si të
21 premtën, vetëm z. Holmes dhe znj. Kalb nuk janë këtu paradite,
22 por do të jenë këtu pasdite.

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Young.

24 Z. YOUNG: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë përfaqësoj z.
25 Fadil Fazliu dhe kam këtu znj. Yuqing Liu dhe znj. Beqiri që

1 na ndjek përmes videolidhjes.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Admiraal.

3 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Mirëmëngjes. Njësoj si të premtën
4 dhe ne nuk kemi ndryshime.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju lutem, sillni
6 dëshmitarin në sallën e gjyqit.

7 Kërkoj ndjesë, fillimisht duhet të paraqesim lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është lënda KSC-BC-
9 2023-12, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit,
10 Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin
11 Kuçit.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

13 Tani mund të sillni dëshmitarin në sallë.

14 Ndërkohë që presim dëshmitarin desha t'ju pyes nëse keni
15 ndonjë përditësim sa i takon kundërpyetjeve prej Mbrojtjes.

16 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo nga ana jonë.

17 Z. REES: [Përkthim] Jo.

18 Z. YOUNG: [Përkthim] Jo.

19 Z. EDWARDS: [Përkthim] Unë do të kem shumë pak pyetje por
20 dhe mund të mos kem pyetje fare.

21 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] E njëjta gjë dhe për ne.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

25 Mirë se u kthyet.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] mirëmëngjesi.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju lutem mos harroni se
3 jeni ende nënë betim, ç'ka do të thotë se duhet t'i
4 përgjigjeni pyetjeve me sinqeritet. Palët do të kalojnë në
5 seancë private kur të jetë e nevojshme në mënyrë që të mos
6 zbulojmë identitetin tuaj.

7 Znj. Menegon, fjala është për ju.

8 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

9 DËSHMITARI: DËSHMITARI 7

10 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

11 Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon:

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

13 PY. Mirëmëngjesi, z. Dëshmitar. Unë quhem Sophie Menegon, dhe
14 përfaqësoj z. Hashim Thaçi. Do t'ju bëj disa pyetje sot
15 paradite në emër të z. Thaçi.

16 PË. Mirëmëngjes, znj. Avokate.

17 PY. Pikësëpari, duam të kuptojmë sa dijeni keni për Çështjen
18 12 meqë jeni staf i ZPS-së. A mund të na thoni fillimisht a e
19 keni lexuar dosjet e Prokurorisë dhe të Mbrojtjes për Çështjen
20 12?

21 PË. Jo.

22 PY. Ju lutem, a mund të na thoni nëse keni qasje në
23 dokumentat e Çështjes 12

24 PË. Po, kam qasje.

25 PY. Faleminderit.

1 PY. Meqë këto dy çështje janë të ndërlydhura, a mund të na
2 thoni nëse keni qasje në dokumentet e Çështjes 06?

3 PË. Po, kam qasje në të gjitha dokumentet.

4 PY. Ju lutem, a mund të na thoni cilat materiale keni lexuar
5 për t'u përgatitur për dëshminë tuaj, përveç deklaratave
6 tuaja?

7 PË. Lexova disa shënime që lidhen -- dokumente që lidhen me
8 mbrojtjen e dëshmitarëve, por nuk më kujtohet ndonjë gjë
9 konkrete.

10 PY. Faleminderit.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në seancë
12 private, znj. Sekretare.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, të kalojmë në seancë
14 private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. Z. Dëshmitar, në Çështjen 12, në deklaratën tuaj P168,

23 keni thënë që ZPS-ja do të kishte pasur -- pra do t'u vendoste

24 burime shtesë dëshmitarëve për të siguruar që dëshmitarët të

25 jepnin dëshmi pa ndërhyrje. A ju kujtohet që keni diskutuar

1 këtë dhe keni dhënë dhe tre impaktet që mund të kishte kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Megjithatë, të premtën nuk na thatë konkretisht çfarë
4 burimesh i dedikoi ZPS-ja kësaj çështje gjyqësore? Ju
5 kujtohet?

6 PË. Po.

7 PY. Po atëherë a mund ta shtjelloni pak përgjigjen tuaj pse
8 nuk mund të na thoni ju cilat ishin masat që ndërmoi ZPS-ja
9 për Çështjen 12?

10 PË. Sepse në të njëjtën kohë kishim dhe Çështjen 06, dhe
11 Çështja 12 ishte paralelisht dhe kishim dhe Çështjen 10 dhe 11
12 paralelisht. Ç'ka do të thotë se kishim disa hetime për pengim
13 të drejtësisë. Unë nuk e dija se sa çështje, në fakt, do të
14 materializoheshin për pengim të drejtësisë. Si përfundim patëm
15 vetëm tre çështje për pengim. Dhe unë nuk mund t'jua
16 specifikoj ju se sa burime kemi pasur ne për Çështjen 10, 12
17 apo 11, edhe të gjitha këto ishin të ndërlidhura me Çështjen
18 06.

19 PY. Tani të flasim për shënimet për kontaktim me dëshmitarët.
20 Kemi parë disa nga dokumentet në Çështjen 12. Z. Dëshmitar, a
21 është e vërtetë që dëshmitarët e Çështjes 06 kontaktoheshin
22 rregullisht prej ZPS-së që të përditësoheshin në lidhje me
23 ecurinë e Çështjes numër 06?

24 PË. E saktë.

25 PY. Për shembull, para që ZPS-ja kishte -- synonte t'i

1 thërriste ata?

2 PË. Po.

3 PY. Pra, që ata janë kontaktuar për t'u informuar se kur do
4 të fillonte çështja, pra gjykimi i ZPS-së, kur pritej?

5 PË. E saktë.

6 PY. Ata u kontaktuan për të planifikuar seancat përgatitore
7 dhe për dëshminë -- dhe dëshminë e tyre dhe për të bërë
8 organizimet e pjesës logjistike për udhëtimin e tyre?

9 PË. E saktë.

10 PY. Për shembull, para që ZPS-ja synonte t'i thërriste ata?

11 PË. Po.

12 PY. Pra, që ata janë kontaktuar për t'u informuar se kur do
13 të fillonte çështja, pra, gjykimi i ZPS-së, kur pritej?

14 PË. E saktë.

15 PY. Ata u kontaktuan për të planifikuar seancat përgatitore
16 dhe dëshminë e tyre dhe për të bërë organizimet e pjesës
17 logjistike për udhëtimin e tyre?

18 PË. E saktë.

19 PY. Janë kontaktuar gjithashtu si pjesë e procesit pas
20 dhënies së dëshmisë, verifikime?

21 PË. E saktë.

22 PY. Përveç pyetjeve lidhur me shqetësimet e mundshme lidhur
23 me sigurinë të dëshmitarëve, përfshirë edhe vizitat në qendrën
24 e ndalimit, pra, të 2023, apo jo?

25 PË. E saktë.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Menegon mund të
2 ngadalësoni pak, ju lutem, me qëllim që të bëhet përkthimi.

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Në rregull, faleminderit. Kërkoj
4 ndjesë.

5 PY. Këto pyetje që kishin të bënin me shqetësimet e sigurisë
6 bëhen edhe sot, pra, edhe pas dhënies së dëshmisë?

7 PË. E saktë.

8 PY. Pra, kemi parë materialet e nxjerra nga ZPS-ja dhe duket
9 se vetëm dy dëshmitarë nga Çështja 06 që kanë të bëjnë -- që
10 lidhen me Çështjen 12 janë pjesë e regjistrimit, të incizimit
11 me video për ndërhyrjen e pretenduar sipas aktakuzës në
12 Çështjen 12. Po i referohem z. Mustafa dhe z. Zyrapi.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtim. Nuk është dhënë
14 arsyeja për këtë se pse dëshmitari duhet ta dijë këtë gjë.

15 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ndoshta, znj. Menegon, së
16 pari duhet të pyesni dëshmitarin a e di këtë gjë apo jo.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. A është e saktë që z. Mustafa dhe z. Bislam Zyrapi janë
19 intervistuar nga ZPS-ja lidhur me ndërhyrjen e pretenduar?

20 PË. Po, jam në dijeni.

21 PY. A ka patur ndonjë dëshmitar tjetër nga Çështja 06 që
22 intervistuar në mënyrë formale, zyrtare të incizuar me zë me
23 video lidhur me pretendimet për ndërhyrje?

24 PË. Nuk më kujtohet.

25 PY. Faleminderit. Në deklaratën tuaj, P128 -- 168, paragrafi

1 10, keni përmendur organizimet shtesë lidhur me sigurinë. A
2 është e saktë që asnjë prej dëshmitarëve që diskutohen në
3 Çështjen 12 nuk janë rivendosur në një vend tjetër si rezultat
4 i sjelljes së pretenduar të të akuzuarve?

5 PË. E saktë.

6 PY. Në të njëjtin paragraf keni përmendur faktin se ZPS-ja ka
7 dashur -- është detyruar që të riorganizojë rendin sipas së
8 cilës ZPS-ja synonte të paraqiste dëshmitarët në Çështjen 06?

9 PË. E saktë.

10 PY. Të premtën ju sqaruat gjithashtu, megjithatë, se ju vetë
11 nuk ishit në dijeni se cilët dëshmitarë në veçanti u
12 zhvendosën, apo u hoqën. Ju kujtohet?

13 PË. Më kujtohet.

14 PY. Pra, siç paraqitet në Shënimin Zyrtar të takimit tuaj me
15 ZPS-në me 24 shkurt 2026, ju nuk jeni në gjendje të thoni
16 cilët dëshmitarë të ZPS-së janë zhvendosur apo hequr
17 konkretisht për shkak të regjistrimeve në qendrën e ndalimit,
18 pra, bisedave me Hashim Thaçin; a është e saktë?

19 PË. E saktë.

20 PY. A mund të sqaroni pse e thoni këtë gjë?

21 PË. Sepse ne po lëvizim dëshmitarë, dhe unë shpesh nuk kam
22 pyetur për arsyen apo s'kam -- pse po i hiqim ata. Thjesht i
23 kemi lëvizur, i kemi hequr, për arsye të ndryshme. Nuk kam
24 pyetur konkretisht pse në mënyrë specifike.

25 PY. Faleminderit. Në dosjen paraprake ZPS-ja pretendon se

1 vetëm dëshmia e Dëshmitarit 002, Bislim Zyrapi, është vonuar
2 në pjesë të konsiderueshme nga ndërhyrja e pretenduar në
3 dëshminë e tij, dhe do të doja ta diskutojmë këtë vonesë të
4 pretenduar.

5 A jeni në dijeni ju se z. Zyrapi është përfshirë në
6 parashtrimin -- në listën paraprake të parashtruar nga
7 Prokuroria për 40 dëshmitarët e parë që do të thërriteshin në
8 gjykim?

9 PË. Po.

10 PY. Pra, nga vetë titulli, kjo listë ishte paraprake?

11 PË. Po.

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund ta
13 paraqesim në ekran. Numri ERN është KSC-BC-2026/F01011/A
14 [Sipas përkthimit] 0117/AO2 RED2, faqja 6. Kërkoj ndjesë, doja
15 parashtrimin kryesor. Pra, F1117, paragrafi 1.

16 PY. Pra, shohim paragrafin e parë që thuhet:

17 "Duke patur parasysh natyrën e përkohshme të kësaj liste
18 dhe fazën e procedurës në gjykimin, lista mbetet nën shqyrtim
19 dhe rregullime mund të bëhen -- ndryshime mund të bëhen në të,
20 qoftë për dëshmitarët dhe deklaratat, ndryshimet e nevojshme."

21 Pra, nuk ishte listë përfundimtar?

22 PË. E saktë.

23 PY. Dhe mund të shohim në ekran që kjo është nxjerrur më 18
24 nëntor 2021?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Korrigjim, është 18 nëntor 2022,

1 dhe shihet në krye të listës.

2 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Faleminderit për
3 korrigjimin.

4 PY. Pra, pajtoheni që është nxjerrë më 18 nëntor 2022?

5 PË. E saktë.

6 PY. Megjithatë, a pajtoheni se dëshmitarët e parë që dhanë
7 dëshmi në Çështjen 06 filluan në prill 2022 të japin dëshmi?

8 PË. E saktë.

9 PY. Pra, kjo listë është nxjerrë pothuajse gjashtë muaj
10 përpara fillimit të paraqitjes së provave të ZPS-së?

11 PË. E saktë.

12 PY. Dhe pajtoheni se ka faktorë të shumtë që mund të kenë
13 ndërhyrë ndërkohë që mund të kenë çuar në ndryshimin e rendit
14 të paraqitjes së dëshmitarëve?

15 PË. Po, pajtohem.

16 PY. A është e saktë se planifikimi i paraqitjes së
17 dëshmitarëve në përgjithësi mbështetet në faktorë të shumtë që
18 mund të ndërhyjnë me njëri-tjetrin?

19 PË. Po.

20 PY. A mund të na tregoni për këta faktorë?

21 PË. Së pari, është disponueshmëria e dëshmitarit, a është apo
22 jo, dhe ka arsye të ndryshme për të cilat dëshmitari mund të
23 jetë i disponueshëm apo jo. Kjo mund të lidhet me shëndetin,
24 me punën dhe arsye të tjera.

25 PY. Në parashtrimet lidhur me njoftimin për rendin e

1 paraqitjes së dëshmitarëve, ZPS-ja gjithmonë i referohet
2 listës së faktorëve kumulativ, pra, të grumbulluar. Dhe po
3 citoj nga paragrafit 3 i parashtrimit të Prokurorisë së listës
4 së dëshmitarëve rezervë, KSC-BC-2020-06 F01811.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Menegon, ndoshta ta
6 shfaqim në ekran që dëshmitari të mund ta shohë.

7 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ju lutem, paraqisni në ekran
8 dokumentin në fjalë.

9 PY. Faktorët e përmendur këtu janë: çështja publike;
10 disponueshmëria e dëshmitarëve, mënyrat e dhënies së dëshmisë,
11 vlerësimet për marrjen në pyetje, kalendari i Gjykatës,
12 konsultimet ndër palë, midis palëve; fushëveprimi, natyra,
13 tema e dëshmisë së pritshme të dëshmitarit dhe materialet që
14 lidhen me të; statusi i paraqitjes së provës, i dëshmisë;
15 rrethanat personale të dëshmitarit; shqetësimet e sigurisë;
16 dhe nevoja për të dhënë njoftim në kohë.

17 A pajtoheni që këto janë -- se faktorë të tillë mund të
18 kenë ndihmuar në renditjen e dhënies së dëshmisë -- rendit
19 sipas të cilit dëshmitarët dhanë dëshmi?

20 PË. Pajtohem.

21 PY. Për shembull, mungesa e disponueshmërisë e paparashikuar
22 e një dëshmitari dhe fakti se marrja në pyetje nga pala --
23 kundërpjetet ndaj dëshmitarit, mund të bëhen në mënyrë më të
24 shpejtë sesa ç'pritej, heqja e dëshmitarëve nga lista a ZPS-
25 së, apo ndryshimi i dhënies së dëshmisë së dëshmitarëve mund

1 të çojë në riorganizmin e planifikimit të paraqitjes së
2 dëshmitarëve?

3 PË. Po.

4 PY. Sa i takon Bislam Zyrapi ai dha dëshmi në korrik 2024.

5 Është e saktë?

6 PË. Nuk e di me saktësi. E di që ka qenë në 2024-n.

7 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran KSC-
8 BC-2020-06 2024-07-01 ENG. Ky është transkripti i dëshmisë së
9 z. Zyrapi në Çështjen 06. Faleminderit, znj. Sekretare.

10 PY. E shikoni z. Dëshmitar, dy rreshtat e fundit thuhet që:

11 "Do të fillojmë marrjen e dëshmisë së dëshmitarit të
12 Prokurorisë [4752]."

13 Që është kodi i dëshmitarit të z. Zyrapi, është e saktë?

14 PË. E saktë.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të shkojmë në
16 krye të dokumentit, ju lutem?

17 PË. E shihni datën 1 korrik 2024? Pra, a pajtoheni se ai ka
18 filluar dhënien e dëshmisë së tij me 1 korrik 2024?

19 PË. Pajtohem.

20 PY. Faleminderit. Z. Dëshmitar, a është e saktë që keni patur
21 vështirësi specifike, konkrete për planifikimin e dëshmisë së
22 këtij dëshmitari?

23 PË. E saktë.

24 PY. Dhe në veçanti se ai kishte probleme shëndetësore të
25 rënda? A ju kujtohet?

1 PË. Po, është e saktë, më kujtohet.

2 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani do të doja të shfaqim në
3 ekran DHT1200128-00129, në shqip dhe në anglisht.

4 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Nuk e di nëse duhet të
5 kalojmë në seancë private, duke patur parasysh temën që po
6 trajtojmë.

7 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Keni të drejtë, i nderuar
8 Gjykatës. Mund t'i bëjmë këto pyetje në seancë të mbyllur.

9 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, seancë
10 private.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po, seancë private.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Z. Dëshmitar, duke patur parasysh faktorët e ndryshëm dhe
8 shembujt që diskutuam, a pajtoheni se riorganizimi i
9 paraqitjes së dëshmitarëve në Gjykatë në gjykime të mëdha për
10 krime lufte është gjë e zakonshme dhe që ndodh shpesh, dhe nuk
11 është e jashtëzakonshme, pra?

12 PË. Po, e saktë.

13 PY. Dhe a pajtoheni që në Çështjen 12 sjellja e pretenduar e
14 të akuzuarve nuk e ka parandaluar ZPS-së që të kontaktojë apo
15 të intervistojë ndonjë dëshmitar?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtim lidhur me bazën për
17 këtë pyetje.

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Nuk do t'i referohem funksionit
19 të tij. E kuptoj se duke patur parasysh funksionin e tij në
20 ZPS ai është në gjendje t'i përgjigjet kësaj pyetje, sepse
21 mendoj që ai duhet të ketë qenë i informuar po të kishin qenë
22 rrethanat e tjera apo diçka ndryshme.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Ndoshta mund. Por ne do të
24 kërkonim që pyetja e parë të bëhet nëse di apo jo përpara që
25 t'i bëhet kjo pyetje.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Dëshmitar, ju dëgjuat

2 shkëmbimin dhe do t'i përgjigjeni pyetjes nëse e dini.

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

4 PY. A doni që ta përsëris pyetjen?

5 PË. Po, përsërisni ju lutem.

6 PY. Në këtë çështje, a pajtoheni se sjellja e pretenduar e të

7 akuzuarve nuk e ka parandaluar ZPS-në që të kontaktojë apo të

8 intervistojë ndonjë dëshmitar?

9 PË. Nuk e di.

10 PY. Sipas njohurisë tuaj nuk është -- janë pezulluar -- nuk

11 është pezulluar procesi në Çështjen 06?

12 PË. Është pezulluar procesi në Çështjen 06.

13 PY. Cilën, kur?

14 PË. Ka patur informacion lidhur me mënyrën se si Mbrojtja

15 mund të kontaktojë dëshmitarët, ka patur rregullën në Çështjen

16 06.

17 PY. Pyetja ime është ndoshta s'ishte e qartë, por gjykimi në

18 çështjen në Çështjen 06, pra vijimi i gjykitimit në këtë

19 çështje, paraqitja e provave të ZPS-së apo të Mbrojtjes nuk

20 është ndërprerë për periudha të gjata kohore mesa e dini ju?

21 PË. Ka qenë një periudhë e gjatë kohore për të organizuar

22 paraqitjen e dëshmitarëve në Çështjen 06.

23 PY. Do të kaloj në diçka tjetër. Meqenëse se z. Thaçi është i

24 akuzuar se ka nxjerrë informacion konfidencial, do të doja të

25 diskutojmë nëse statusi i dëshmitarit të ZPS-së apo

1 fushëveprimi, qëllimi i dëshmisë, provave të dëshmitarëve --
2 dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së njiheshin për publikun më
3 parë gjatë apo pas dëshmisë së tyre në Çështjen 06. Të premten
4 ju thatë se vetë, ju vetë ishit të informuar se cilët
5 deklarata të dëshmitarëve i janë nxjerrë Mbrojtjes sepse
6 pastaj ju keni thirrur dëshmitarët për t'i informuar ata për
7 këto nxjerrje?

8 PË. E saktë.

9 PY. Pra, kjo do të thotë se në përgjithësi ju keni një ide
10 lidhur me natyrën e dëshmisë së dëshmitarëve, pra, të
11 dëshmitarëve të ZPS-së?

12 PË. Në përgjithësi po.

13 PY. Në deklaratën tuaj në P168 paragrafi 8 keni thënë se keni
14 shpjeguar se statusi i një personi si dëshmitar i ZPS-së
15 klasifikohet nga ZPS-ja si konfidencial përpara se ata të
16 japim dëshmi pavarësisht nëse dëshmitari -- ndaj dëshmitarit
17 janë caktuar masa Mbrojtëse edhe në qoftë se dëshmitari pritet
18 të japë dëshmi publikisht, mund të kërkojë masa mbrojtëse në
19 çdo kohë përpara së dhënies së dëshmisë së tij.

20 PË. E saktë.

21 PY. Pra, Dëshmitar, a është e saktë se disa dëshmitarë kanë
22 nxjerrë në mënyrë të vullnetshme nga ana e tyre publikut
23 faktin se ata do të ishin dëshmitarë -- që janë dëshmitarë të
24 ZPS-së? E kanë bërë publike?

25 PË. Ka ndodhur në Çështjen 06.

1 PY. Për shembull, disa kanë thënë që do të intervistoheshin
2 nga ZPS-ja apo që ishin intervistuar nga ZPS-ja; e saktë?

3 PË. E saktë.

4 PY. Dhe e ngjashme, ndonjëherë ata kanë informuar të afërmit
5 e tyre, shokët e tyre apo dhe publikun se do të shkonin të
6 jepnin dëshmi në çështje konkrete në gjykim?

7 PË. E saktë.

8 PY. Dhe dëshmitarët kanë të drejtë të nxjerrin këtë
9 informacion?

10 PË. Ky është vendimi i tyre.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do të doja të kalojmë në seancë
12 private, ju lutem.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kalojmë në seancë private.

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

14 PY. Të premtën, ju shpjeguat se kur një dëshmitar e

15 komunikon, nxjerr për publikun se është dëshmitar përpara se

16 të japë dëshmi, ai nuk e humb mbrojtjen që mund të ketë.

17 Megjithatë, kur dëshmitari përfiton dhe ka masa mbrojtëse, ai

18 mund të shqyrtojë, mund të vendosë se nuk ka nevojë për këto

19 masa mbrojtëse më tej, dhe t'i kërkojë heqjen e tyre që

20 miratohet nga Trupi Gjykses. A është e saktë.

21 PË. E saktë.

22 PY. Pra, masat mbrojtëse nuk janë detyruesisht të përhershme,

23 ato mund të ndryshojnë.

24 PË. E saktë.

25 PY. Tani do të doja të flasim për Dëshmitarin 1, Rustem

1 Mustafa. Ai ka dhënë dëshmi në Çështjen 06 në korrik 2023 pas
2 marrëveshje për pranimin e faktit si nga midis palëve. Dhe
3 sipas deklaratës tuaj P168 ai nuk ka patur masa mbrojtëse. A
4 është saktë?

5 PË. E saktë.

6 PY. E dini pse s'ka pasur masa mbrojtëse ndaj tij, për të?

7 PË. Sot më herët në mëngjes shpjegova se si prokurori vendos
8 lidhur me masat mbrojtëse. Nëse personi është publik dhe i
9 njohur, nëse personi ka dhënë dëshmi më parë në seanca publike
10 në mënyrë të hapur në gjykata ndërkombëtare, tribunale
11 ndërkombëtare apo Gjykata vendore, pra, për z. Mustafa, ai ka
12 dëshmuar më parë në mënyrë të hapur dhe është person shumë i
13 njohur dhe figurë e njohur në Kosovë.

14 PY. Faleminderit. Në fakt, ju përmendët dëshmitë e tij të
15 mëparshme. A është e saktë që ai ka dhënë -- është paraqitur
16 dhe ka qenë edhe i akuzuar dhe ka dëshmuar në çështjen Latif
17 Gashi dhe të tjerë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe
18 Gjykatën e Apelit në Prishtinë?

19 PË. Nuk i di hollësitë e çështjeve apo gjykimeve apo
20 Gjykatave në të cilat ka dhënë dëshmi, por jam në dijeni se ai
21 ka dhënë dëshmi më herët.

22 PY. A jeni në dijeni që komentet e tij të mëparshme janë
23 komentuar nga media?

24 PË. Nuk jam në dijeni.

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dëshiroj të paraqitet në ekran

1 dokumenti në shqip dhe në anglisht që mban numrin DHT1200038-
2 0040.

3 PY. Ky është një artikull i datës 6 dhjetor 2018 nga
4 Telegrafi. Titulli është "Për çfarë krimesh është dënuar z.
5 Rrustem Mustafa?". Besoj që mund ta lexoni dhe vetë që thuhet
6 që:

7 "Ish-oficerë të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
8 UÇK, të zonës operative të Llapit, përfshirë dhe komandantin e
9 zonës, Rrustem Mustafën, i njohur me nofkën 'Remi' ishin
10 dënuar në 2013-n nga Gjykata e Prishtinës për krime lufte.

11 "Komandat 'Remi' ishte pjesë e të ashtuquajturit 'Grupi i
12 Llapit' që po gjykohej prej vitesh për krimet e pretenduara të
13 luftës."

14 A pajtoheni se në këtë artikull flitet për dënimin e z.
15 Mustafa edhe krimet për të cilat është dënuar ai gjatë luftës?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Përsëri, i nderuar Gjykatës,
17 dëshmitari nuk ka thënë që e ka parë këtë artikull. Duhet të
18 bëjë pyetjen e parë një herë, pastaj duhet të bëjë pyetjen
19 pasuese.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Halling, nuk ka problem.
21 Mund ta konfirmojë me dëshmitarin se cila është përmbajtja e
22 artikullit dhe pastaj mund të bëjë pyetje të tjera. Sigurisht
23 që ne të gjithë mund ta lexojmë artikullin. Megjithatë, mendoj
24 se nuk është se ka problem me këtë lloj pyetje, kështu që mund
25 të vazhdoni, znj. Menegon me pyetjen tuaj.

1 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

2 PY. Nuk iu përgjigjët pyetjes time, Dëshmitar. Po jua bëj dhe
3 një herë atëherë. A pajtoheni me mua që në këtë raport flitet
4 për dënimin e z. Mustafa dhe ka të bëjë me krimet e
5 pretenduara gjatë luftës.

6 PË. Po.

7 PY. A e keni parë më përpara këtë artikull?

8 PË. Jo.

9 PY. Si pjesë e detyrave tuaja dhe si detyrë që keni pasur për
10 të kërkuar burime të hapura, a është ky një lloj informacioni
11 duhet ta kishit kërkuar, ose mund ta kishit parë?

12 PË. Sikurse e thashë, z. Mustafa është një person publik edhe
13 i njohur në Kosovë. Unë e di që ai ka qenë pjesë e disa
14 hetimeve dhe lëndëve gjyqësore në Kosovë, por nuk më kujtohet
15 të kem lexuar këtë artikull konkretisht, dhe nuk më kujtohen
16 detaje që kanë të bëjnë me z. Mustafa.

17 PY. Në rregull.

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Le të kalojmë te faqja 5. Drejt
19 fundit të faqe.

20 PY. Dëshmitar, a mund të lexoni fjalinë e tretë nga fundi që
21 fillon me "Sot ...".

22 PË. "Gjatë ditës së sotme avokati i komandant Remit bëri të
23 ditur se klienti i tij është ftuar nga Zyra e Prokurorit të
24 Specializuar në Hagë për një intervistë."

25 PY. Vazhdon me fjalinë tjetër.

1 PË. "Sipas avokat Arianit Koci, Rrustem Mustafa do të
2 paraqitet vullnetarisht në Hagë në muajin janar."

3 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. A është e saktë që në këtë
4 artikull thuhet që me 6 dhjetor 2018, z. Mustafa përmes
5 avokatit të tij ka thënë që do merrej vullnetarisht në Hagë
6 për intervistë. A është informacion i saktë ky?

7 PË. Po.

8 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ju lutem, do kërkoja të
9 regjistrohej në prova ky dokument.

10 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A ka kundërshtime.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë për themelin se nuk
12 është kundërshtuar themeli. Dëshmitari thjesht mund të njohë
13 personin që është i përshkruar në këtë artikull. Por, shumë
14 shpejt Mbrojtja do ketë mundësi që të kërkojë pranimin e
15 dokumenteve të cilat nuk janë të lidhura me një dëshmitar.
16 Por, është e nevojshme që të ketë një lidhje të përgjithshme
17 dhe ne themi që pragu i nevojshëm nuk përmbushet këtu për
18 pranimin e këtij dokumenti si provë gjyqësore.

19 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Neve nuk pajtohemi me këtë
20 parashtrim sepse sipas z. Mustafa fakti që ai ishte person
21 publik dhe kishte dhënë deklaratë, ne mendojmë që një gjë e
22 tillë do ketë qenë shumë e rëndësishme si për çështjen e
23 Prokurorisë ashtu edhe për çështjen dëshmitarëve. Për këtë
24 arsye ne mendojmë që ky dokument duhet të pranohet në prova
25 gjyqësore.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Përderisa dëshmitari tha që
2 gjatë përgatitjes së tij për të vlerësuar nivelin e rrezikut
3 të dëshmitarëve ka lexuar artikuj të ndryshëm në burime të
4 hapura dhe duke qenë që ai tha që z. Mustafa ishte person
5 publik i njohur publikisht, unë mendoj që ekziston bazë e
6 mjaftueshme për pranimin e këtij dokumenti, kështu që për
7 rrjedhojë këtë dokument e pranoj në prova gjyqësore.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
9 Gjykatës. Dokumenti me numër ERN DHT00038 deri në 00040, në
10 anglisht dhe në shqip do të marrë numrin e provës materiale
11 1D00003. Klasifikimi është publik. Faleminderit.

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare.

13 Tani do kërkoj që të paraqitet një tjetër artikull në
14 ekran. Numri i artikullit është DHT1200231-00232, në versionin
15 në shqip dhe në versionin në anglisht, ju lutem.

16 PY. Ky është një artikull që mban datën 7 dhjetor 2018.
17 Titulli i artikullit është "Ish-komandanti i UÇK-së Rrustem
18 Mustafa, Remi, shkon në Hagë". Në faqen 1 të artikullit,
19 thuhet se:

20 "Rrustem Mustafa, Remi, është ish-komandant i Zonës
21 Operative të UÇK-së në Llap dhe deputet i Kuvendit të Kosovës
22 i cili do të dalë në Prokurorinë Speciale në Hagë më 14 janar,
23 e ka bërë të ditur avokati i tij, Arianit Koci".

24 Z. Dëshmitar, a e keni parë më përpara këtë artikull?

25 PË. Nuk më kujtohet.

1 PY. A pajtoheni që në këtë artikull tregohet data e
2 planifikuar për dëshminë e z. Rustem Mustafa që është data 14
3 janar?

4 PË. Po, pajtohem.

5 PY. A është ky një lloj informacioni që ju ose zyra juaj
6 kërkonte ose mundohej që të gjente përpara sesa ju të
7 planifikonit intervistë me dëshmitar?

8 PË. Po, është e saktë, sepse në atë kohë oficerët më të lartë
9 në hierarki të UÇK-së dhe anëtarë të UÇK-së informonin
10 publikisht edhe thonin publikisht që do intervistoheshin nga
11 ZPS-ja. Kjo ishte diçka e zakonshme.

12 PY. Në rregull.

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dua që të pranohet ky dokument.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka ndonjë kundërshtim?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Me çfarë kuptoj e morët vendimin
16 për sa i takon këtyre lloj dokumenteve.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, varet nga natyra e
18 dokumenteve, kështu që nuk e di, domethënë, në qoftë se keni
19 përgjigje për këtë apo jo, kundërshtoni apo jo?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk e kundërshtojmë që ky dokument
21 ka qenë në media. Por thjesht kundërshtojmë relevancën, çfarë
22 rëndësie ka ky dokument për sa i takon kësaj çështje
23 gjyqësore.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit për komentet,
25 megjithatë dokumenti pranohet në prova gjyqësore.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,
2 dokumenti me numër ERN DHT1200331 deri në 00332, në shqip dhe
3 në anglisht do të marrë numrin e provës 1D00004. Klasifikimi
4 është publik.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

6 I kërkoj Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin
7 DHT1200333-00334, në shqip dhe në anglisht.
8 PY. Ky është një artikull tjetër që mban datën 15 janar 2019
9 nga KoSSev që thotë që "Në pyetje Cena dhe Mustafa, nesër në
10 Hagë fillon marrja në pyetje e Lushtakut".

11 Në këtë dokument thuhet që:

12 "Ish-pjesëtarja e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut
13 Sabahajdina Cenu [Sipas përkthimit], dje në zyrat e EULEX-it
14 është marrë në pyetje nga Prokuroria Speciale si e dyshuar,
15 ndërsa në të njëjtën kohë është marrë në pyetje Rrustem
16 Mustafa - Remi ...

17 "Rrustem Mustafa i cili ka udhëtuar drejt Hagës dje po
18 merret në intervistë sot. Ndërsa nesër duhet të fillojë
19 pyetjet Sami Lushtakut".

20 Dhe në fund thuhet që:

21 "Prokuroria, ata, domethënë Prokuroria ishte serioze në
22 pyetjen e tyre dhe në çdo pyetje iu përgjigjëm seriozisht. Unë
23 kam premtuar se do ta mbroj UÇK-në këtu, por UÇK-ja më ka
24 mbrojtur', ka thënë Mustafa sipas raportimeve."

25 Z. Dëshmitar, a e keni parë më herët këtë dokument?

1 PË. Nuk më kujtohet. Sikurse e thashë dhe më herët z. Mustafa
2 është një person publik i njohur mirë në Kosovë kështu që ka
3 pasur artikuj të tillë me qindra sa i takon intervistës së tij
4 në Hagë. Ky dokument ose ky artikull konkret mua nuk më
5 kujtohet.

6 PY. Në rregull.

7 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja e dytë
8 në fillim të faqes.

9 PY. Ju lutem lexoni fjalinë e parë.

10 PË. "I pyetur se në çfarë cilësie është thirrur për t'u marrë
11 pyetje në Hagë ai përsëriti se ishte dëshmitar i dyshuar."

12 PY. Z. Dëshmitar, a është e saktë se sipas artikullit z.
13 Mustafa e ka thënë vetë që ZPS-ja e ka marrë në intervistë si
14 dëshmitar të dyshuar?

15 PË. Ai është intervistuar si dëshmitar i dyshuar. Po, kjo
16 është e saktë.

17 PY. Dhe sikurse mund ta shikoni që ai e ka konfirmuar vetë në
18 media që ZPS-ja e ka marrë në intervistë si të dyshuar. A
19 është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Kërkojmë që të pranohet
22 dokumenti.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pranohet dokumenti.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me numër ERN

1 DHT12000333 deri në 00334 në anglisht dhe në shqip do të marrë
2 numrin e provës 1D00005. Klasifikimi është publik.
3 Faleminderit.

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

5 Tani dëshiroj që të paraqitet në ekran një tjetër
6 dokument. Është dokumenti që është në të dyja versionet, në
7 shqip dhe në anglisht që mban numrin e identifikimit
8 SPOE00330381.

9 PY. Ky është një postim në Facebook i Rustem Mustafës.
10 Atëherë edhe një herë, z. Dëshmitar, a e shikoni dokumentin që
11 keni në ekran që është një postim në Facebook i Rustem
12 Mustafës me datë 15 janar 2019?

13 PË. Po, e shoh.

14 PY. A e shihni pjesën ku thuhet se intervista në Hagë ka
15 përfunduar dhe që:

16 "Udhëheqësit e UÇK-së duhet të jenë të lirë.

17 "E vërteta duhet të vihet shpejt dhe pa vonesë në dritë.
18 Gjykata Speciale duhet t'i mbyllë, duhet të përfundojë në afat
19 të përgjegjshëm dhe të drejtë. Kombi shqiptar duhet të marrë
20 përsipër angazhime të reja racionale dhe zhvillimore."

21 A e keni parë këtë postim më përpara, z. Dëshmitar.

22 PË. Nuk më kujtohet.

23 PY. Në kuadër të asaj çfarë thashë, a është e saktë që në
24 këtë postim z. Rustem Mustafa diskuton UÇK-në dhe komenton
25 gjithashtu për procesin gjyqësor në DHSK, publikisht e bën

1 këtë gjë? A është e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, është e saktë.

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Të kalojmë në fund të
4 dokumentit.

5 PY. Në versionin në shqip mund të shikoni një shenjë që është
6 me gishtin e madh sipër që është 766, që do të thotë që kanë
7 bërë *like* 766 veta, dhe shikoni po ashtu që janë bërë 166
8 [komente] dhe është ndarë tre herë dokumenti. A pajtoheni që
9 ky dokument është shpërndarë dhe është mbuluar gjerësisht duke
10 pasur parasysh komentet dhe atë çfarë thotë autori lidhur me
11 përmbajtjen e tij?

12 PË. Nuk do thoja, nuk do komentoja që është numri i lartë.
13 Nuk di si t'i përgjigjem kësaj pyetje. Nuk mendoj kështu.

14 PY. Ky është një dokument i cili i është dhënë Mbrojtjes nga
15 ZPS-ja. Domethënë që është pjesë e hetimeve që ka bërë ZPS-ja
16 për këtë dëshmitar. A mund ta themi këtë gjë?

17 PË. Po, mund ta themi këtë gjë.

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dëshiroj që ky dokument të
19 pranohet në prova gjyqësore.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar, se
21 përkundrazi do përsërisnim veten.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
23 Gjykatës. Dokumenti me numër ERN SPOE00330366 deri në 00330381
24 në shqip dhe në anglisht do të marrin numrin e provës 1D00006.
25 Klasifikimi është publik. Faleminderit.

1 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

2 PY. Z. Dëshmitar, a jeni ju i informuar që z. Mustafa ka
3 dhënë gjithashtu një intervistë publike në televizion në vitin
4 2023 më 12 prill 2023, ku ai diskuton intervistën që i ka
5 dhënë ZPS-së për Çështjen 06. I referohem konkretisht provës
6 P153. A jeni në dijeni të kësaj?

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Menegon, mbase mund të
8 ishte më mirë që ta paraqisni dokumentin në ekran para sesa të
9 bëni pyetjen.

10 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po, keni të drejtë. I kërkoj
11 Sekretares të paraqesë në ekran provën P153, në shqip dhe në
12 anglisht. Faleminderit, znj. Sekretare.

13 PY. Mund të shihni që ky është një transkript i një programi
14 televiziv KTV-KohaVision. Pra, sikurse mund ta shikoni kjo
15 është një intervistë e datës 12 prill 2023, dhe në të ka marrë
16 pjesë, ndër të tjerë, dhe Rrustem Mustafa. A pajtoheni?

17 PË. Po, pajtohem.

18 PY. Keni dëgjuar për këtë intervistë më herët?

19 PË. Nuk mund kujtohet.

20 PY. Faleminderit. Folësi i parë këtu thotë që:

21 "Do të flasim për pretendimet e Prokurorisë Speciale të
22 paraqitura për shqyrtimin fillestar që nisi në Hagë ...
23 shikuar nga prizmi i një ish-komandanti të një zone operative
24 të UÇK-së. Z. Rrustem Mustafa ..."

25 A pajtoheni që mbi bazën e këtij dokumenti z. Mustafa ka

1 komentuar kundër procesit gjyqësor në DHSK, dhe këtë e ka bërë
2 publikisht?

3 PË. Po, pajtohem.

4 PY. Faleminderit.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga
6 ekрани.

7 PY. z. Dëshmitar, a jeni në dijeni që vetë z. Mustafa i ka
8 thënë medias me 1 korrik 2023 që ai do jepte dëshmi brenda një
9 jave për çështjen 06 në DHSK?

10 PË. Sikurse e kam thënë disa herë, z. Mustafa është person
11 publik. Ai botonte çdo gjë, në veçanti çdo gjë që lidhej me
12 ZPS-në, kështu që konkretisht nuk më kujtohet ky moment
13 konkret, por më kujtohet që ai e ka bërë publik faktin që do
14 vinte të jepte dëshmi këtu.

15 PY. Në fakt, ka një fakt për cilin palët janë pajtuar, që
16 është parashtrimi F764. A pajtoheni që fakti që ai do vinte do
17 jepte dëshmi këtu në Hagë është mbuluar gjerësisht në Kosovë,
18 domethënë nga media?

19 PË. Po.

20 PY. Do kërkoj që të paraqiten disa artikuj lidhur me këtë
21 temë sepse natyra e shpërndarë e raportimit mbi intervistën
22 është një temë e rëndësishme për ne.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Për këtë do i kërkoj Sekretares
24 të paraqesë në ekran një dokument si një shqip dhe në
25 anglisht, më konkretisht dokumenti ka numrin DHT12000095-0095.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Ky artikull lidhet me faktin për
2 të cilët palët kanë rënë dakord. Domethënë nuk e di çfarë
3 kuptimi ka pyetja e avokates sepse për këtë kemi rënë dakord.

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Për ne, ne jemi të interesuar
5 tek pjesa që kjo është një -- çështja është mbuluar gjerësisht
6 nga media. Atëherë përderisa jemi pajtuar sikurse e tha edhe
7 Prokurori sa i takon faktit, dua gjithsesi që të trajtoj
8 dokumente të kësaj natyre për të dhënë më shumë kontekst për
9 sa i takon Mbrojtjes edhe qëndrimit dhe argumenteve të saj.

10 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, do e pranoj, do e
11 pranoj këtë pistë pyetjesh.

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Dëshmitar, sikurse mund ta shikoni ky është një artikull
14 për shtyp i Kontakt Plusit, data 1 korrik 2023, ku thotë që
15 "Rrustem Mustafa ka marrë fletëthirrje nga Gjykata Speciale në
16 Hagë".

17 E shikoni, Dëshmitar?

18 Pra thuhet:

19 "Rrustem Mustafa është thirrur për të dhënë dëshmi në
20 Hagë.

21 "Mustafa i ka thënë këtij kanali televiziv që është -- do
22 shkojë do japë dëshmi në Hagë pas një jave."

23 Dëshmitar, a e keni lexuar, e keni parë këtë dokument më
24 përpara?

25 PË. Nuk më kujtohet.

1 PY. Megjithatë, përmbajta e tij është konsistente, domethënë
2 është në një linjë me atë çfarë ka deklaruar vazhdimisht në
3 media z. Mustafa, domethënë që ai do vinte dhe do jepte dëshmi
4 këtu në Hagë. A është kështu?

5 PË. Po, e saktë.

6 PY. Thuhet gjithashtu që z. Mustafa është thirrur që të japë
7 dëshmi për akuzat e pretenduara ndaj udhëheqësve të UÇK-së. A
8 pajtoheni ju me këtë dhe a pajtoheni me faktin që bëhet fjalë
9 për një referencë të plotë për Çështje 06, domethënë çështjen
10 e Prokurorisë kundër z. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi?

11 PË. Po.

12 PY. A pajtoheni se përpara sesa të fillonte të jepte dëshmi
13 ai këtu, pjesa dërmuese e njerëzve në Kosovë e dinin që ai do
14 vinte dhe do jepte dëshmi për Çështjen 06?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Kërkon spekulim, se kur thua pjesa
16 dërmuese e popullatës është spekulim.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do e shpreh ndryshe, do e them
18 ndryshe pyetjen.

19 PY. Duke marrë parasysh përmbajtjen e këtij artikulli dhe
20 faktin që z. Mustafa, domethënë, dëshmia e tij këtu është
21 komentuar dhe është mbuluar gjerësisht nga media, a mendoni që
22 njerëzit në Kosovë do ishin në dijeni të faktit që ai do vinte
23 për të dhënë dëshmi për Çështjen 06?

24 PË. Ishte fakt publik, ishte informacion publik, ishte
25 informacion i gjerësishtëm, i njohur gjerësisht nga publiku që

1 ai do vinte të jepte dëshmi në Çështje 06 këtu.

2 PY. Faleminderit.

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet ky
4 dokument.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim nga ZPS-ja.

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Dokumenti pranohet.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
